

INTERVISTË ME DILAVER PEPËN

Prishtinë | Data: 13 shkurt, 2022

Kohëzgjatja: 84 minuta

Të pranishëm:

- Dilaver Pepa (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zotëri Dilaver, nëse mundeni me u prezantu, me na tregu diçka për familjen e ju, prejardhjen...

Dilaver Pepa: Quhem Dilaver Pepa, i lindur në 1955 në Pejë. Rrjedh prej një familjeje mesatare, qytetare, që kanë punu ton' jetën me zanat, si fotografë. Përndryshe, baba im ka punu në rini të hershme edhe si tregtar, ka qenë, nëpër krejt Jugosllavinë, ish-Jugosllavinë atëherë... kanë shetitë me tregti, me qylyma me... E mixhën e kom pasë fotograf... fotografi i parë që ka qenë Riza Pepa, po mjerisht ata në njëzet e... n'njëzet... në '43-tën, dytën dikur, nuk dihet bash tamon, e kanë vra. Tash kush e ka vra, a e kanë vra partizanët a ballistët osht' enigmatike hala s'kanë mujtë me e deshifru.

Kështu që, fëminia jeme si e gjithë moshatarëve të mi atëherë ka qenë shkollë, lojë. Dyqanin e kem pasë, prej '55-tës faktikisht kur kom le unë edhe ma herët. Me pesë-gjashtë vjeçar kom fillu veç me dalë n'dyqan, jo me punu se shumë i vogël, po me iu bajtë farë uji, me iu ndihmu diçka, shko bleje ato, shko bleje kto. Kështu që zanatin si zanat kom fillu pak ma asi, me 15-16 vjeçar me punu veç me t'madhe. Po mendoj, e kom ditë majft mirë që kom mujtë me punu. Shkollën fillore e kom kry në Pejë, "Miladin Popović". Gjimnazin "11 Maji" atëherë ka qenë, tash "Bedri Pejani", në Pejë. Kom fillu studimet në '74-tën në Fakultetin Juridik. E kom ndërpre të tretin vit. Arsyet kanë qenë t'ndryshme.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë për dyqanin e babës ju. Ku ka qenë ai dyqan dhe si e kujtoni ju si fëmijë domethënë atë... qysh është dokë ai dyqani? Çka ka pasë brenda? Çfarë njerëz kanë ardhë?

Dilaver Pepa: Po. Dyqanin e kem pasë faktikisht... thashë më herët dika të '50-ën, të '55-tën, po ato s'i mbaj mbend se unë në të '55-tën jom le. Po e kem pasë dyqanin... çka unë e mbaj mend e nëse Pejë... s'di sa e njifni... tash është shtëpia e mallrave. Aty e kem pasë deri në të '73-tën. Ka qenë një dyqan i lidhun me qarshi t'gatë faktikisht, një rend. Dyqani ka qenë mjaft, për atë kohë po thom, i pajisun. Ka pasë reflektorat, po jo reflektora blica qysh janë tash po reflektora me drita. Ka qenë një kamerë e madhe, ku janë fotografu, për dokumenta, për qejf. Atëherë ka qenë bajegi interesant me

shku me u fotografu. Janë përgatitë njerëzit një javë përpara, “Kem me shku me bo një set xhirimeve t’fotografisë”. Kështu që, dyqani ka qenë i thjeshtë... po mendoj kështu a din, jo si tash qysh janë ateliet e ndryshme, po ka funksionu.

Atëherë ka pasë pak fotografë. Në Pejë për shembull kanë ekzistuar dy-tre fotografë. Foto Pepa, Foto Gashi, Foto Nazmia, e kështu. Kështu që, tonë kohës, mbas shkollës, mbas shkollës fillore sa kam qenë, kom shku n’dyqan. Rinia jeme ma tepër i përket i dyqanit sesa n’rrugë, n’mahallë aty te shpia ku kem lujtë. Kështu që kjo është njëfarë si...

Anita Susuri: Thatë që e keni trashëgu profesionin prej axhit t’juj, që fillimisht ai është marrë me...

Dilaver Pepa: Po.

Anita Susuri: ...me fotografim. A dini diçka ma shumë prej nga... si, si është mirrë ai me fotografi? Si ka ardhë deri te ajo me u marrë me, me këtë profesion?

Dilaver Pepa: {Ngre supet} Sa na kanë spjegu se tash na, axhën s’e njoh... e njohim vetëm përmes fotografive. Ai si i ri 17-18 vjeçar... tash a ka qenë Zagreb, a ku... kanë udhëtuar atëherë jo me tregti, jo me asi edhe ka fillu zanatin prej... s’po di tash, a din, s’jom i sigurt prej kujna edhe ka fillu me u marr me fotografi. Kur ka ardhë në Pejë, prej atjeshit... atëherë në Pejë s’ka ekzistuar fotograf fare, s’ka pasë. Nashta ka ekzistuar po... na bash s’e dijmë. Kështu që, o marrë me fotografi. Atëherë s’ka pasë dyqan, axha, po i ka punu n’shpi. Atëherë kanë qenë kushtet jashtëzakonisht të vështira. O duhtë me fotografu n’shpi, me ja... me ja rregullu ni dhomë si t’errët. Atëherë jonë kanë si banjo, si asi ku i kanë mlu krejt... edhe aty u duhtë me punu me i zhvillu filmat, me i zhvillu fotografitë, m’i terë, m’i tha e kështu.

E mbasi që axhën... u zhduk faktikisht ‘42- ‘43-tën s’po di, atëherë baba vazhdoi. Mbasi atij i mbetën do aparate, do pajisje, në Pejë s’kishte fotografë, hajde edhe e vazhdon ai. Kështu që, ai ka fillu me u marrë me t’madhe tana, e la tregtinë se përpara e kanë pasë edhe ni dyqan tregtar, para se me e marrë zanatin fotograf baba. Edhe filloi me zanatin e fotografit... kapak-kapak, kapak-kapak, fillunë motrat... i kom pasë tri motra. Njona... e madhja nuk ka punu. [Lirije Pepa](#) ka punu, ajo e dyta me Mersije Pepën. Ato jonë që kanë punu tonë jetën faktikisht me fotografi. Vëllau i madh, Skenderi, edhe ai ka studiu... të gjithë kanë studiu por të gjithë dikah... ka ndodhë diçka edhe i janë ndërpre studimet. Pas Skendës, unë edhe ni vlla tjetër e kom ai... t’gjithë jem marrë faktikisht me fotografi, krejt familja, përveç nanës edhe motrës t’madhe (qesh).

Anita Susuri: E përmendët edhe dyqanin tregtar që e keni pasë... po m’intereson me cilin vend osht’ bo tregtia, a është bo ndoshta me Stambollin, apo Evropën, me Jugosllavinë këto venet ma... Kroacia, Sllovenia?

Dilaver Pepa: Atëherë sa... simbas gojëdhanave që thojnë, prej nanës e prej asi... o bo me Stambollin, o bo me Greqinë. Tash ish-Maqedonia, Shkupi, atëherë ka qenë i Kosovës faktikisht vilajeti... e n’qeto rajone. Në Shqipëri, në Shkodër, masi Shkodrën e kem pasë si qytetin ma t’afërt këtu... atje kanë shku

shpesh. Tregtinë e kanë zhvillu me gjithçka. Kur e ka hapë dyqanin, atëherë ka qenë si tash t'thom ni mini-market i vogël, a din, me çdo send. Po ato s'e mbaj mend, veç prej të thanunave kështu që... unë e mbaj mend fotografë kur kem qenë, kur e kem pasë shpinë te Shtëpia e Mallrave. Aty kemi punu... ka ekzistuar deri në të '74-tën. Në të '74-tën kemi dalë... masi e murrën komuna për me e ndërtu Shtëpinë e Mallrave, na jepi një dyqan përballë edhe kështu që kem vazhdu.

Anita Susuri: Po m'intereson edhe qysh ka qenë atëherë... ju si fëmijë domethënë kur keni qenë fëmijë si e kujtoni... shtresa e njerëzve ose çfarë... si me thanë, popullsi... ju keni qenë si... ndoshta tregtarët kanë qenë në pozitë më të mirë ekonomike. Çfarë qyteti ka qenë Peja? Çfarë njerëz ka pasë?

Dilaver Pepa: Peja si Pejë, qytet shumë i bukur (qesh). Sa i përket jetesës n'atë kohë... unë kom jetu në një lagje kah Kapeshnica ku të gjithë kanë qenë faktikisht... një barazpeshë e kanë pasë. Na si familje zejtarësh kemi jetu mirë, a din nuk kemi pasë farë problemi ekonomik. Kushtet atëherë kanë qenë, t'shkollimit, a din, po foli për ish-Jugosllavinë, kanë qenë si e dijmë, pa pare shkolla, shëndetësia. Po jetesa n'përgjithësi ka qenë e mirë, a din, nuk muj me thanë qe kem pasë farë pasoje. Pavarësisht që nëpër fshatrat ku kanë pasë me, a din, ndjekjen e... kinse mbledhjen e armëve, tepricës, e kanë hekë shumë, po unë si fëmijë nuk e mbaj mend që kem asi. Kem qenë ni familje mesatare a din, nuk kem qenë shumë t'pasur por edhe as... mesatare në Pejë. Faktikisht krejt lagjja ka qenë e tillë, a din që... plus zanatlitë kanë jetu pak ma, ma mirë se kanë pasë t'ardhuna për çdo ditë, a din, nuk e kanë pritë mujin me e marrë rrogën.

E sa më kujtohet në Pejë, atëherë ka pasë edhe fabrika mjaft, kanë ekzistuar nja dhjetë fabrika. Ka qenë e zhvillime n'përgjithësi, a din... n'krahësim me qytetet tjera të Kosovës ka qenë një ndër qytetet ma të zhvillime. E kjo është ajo sa i përket...

Anita Susuri: Ju keni qenë edhe ndoshta shumë i ri atëherë, por a ju kujtohet periudha e Rankoviçit¹, domethënë vitet e '60-ta, '65, kur njerëzit janë largu. A keni najfarë, si me thanë, najfarë kujtimi lidhur me qat'...

Dilaver Pepa: Kujtime prej bisedave për shembull, se unë kam qenë i ri atëherë kanë qenë '55-tat, '60-tat kur kanë shku me t'madhe për Turqi. Prej bisedave t'motrës të madhe e... faktikisht baba i mbajke do letra gjithmonë edhe i rujke në një... e kem pasë një arkë n'shpi t'metalit, aty e mbajke një ditar. Mbas vdekjes së babës, në të '70-tën kur ka vdekë, kjo motra tani tu i asi shfletu edhe po na tregon letrat... faktikisht i kem pasë të përgatitme krejt dokumentacionin për me shku për Turqi, vitin '55, qat' vit kur kom lindë unë. Po motra me insistimin e sej, e ka kundërshtu shkuarjen atje. Ajo ka qenë pak ma e madhe, ma e madhe se unë dymbëdhjetë vjet faktikisht ajo dikah n'moshën 15-16 vjeçare, në gjimnaz veç ka qenë edhe e ka kundërshtu me t'madhe. Kështu që, i kemi pshtu shkuarjes në Turqi. E sa i përket kohës së Rankoviçit veç prej bisedave kështu, se jo që e mbaj mend diçka si...

¹ Aleksandar Ranković (1909-1983) ishte hero partizan serb i cili mori pozitën e Ministrit të Punëve të Brendshme në Jugosllavi dhe ishte udhëheqës i Inteligjencës Ushtarake pas Luftës së Dytë Botërore. Ai krijoi një sistem terrori në Kosovë, pasi që e konsideronte atë si rrezik për sigurinë e Jugosllavisë nga 1945-1966, kur dhe ai u largua nga Lidhja Komuniste.

Anita Susuri: Po, keni qenë shumë i ri. Deshta edhe pak për dyqanin me ju pytë, m'tregutë kur keni fillu, ndoshta 15 vjet, por besoj edhe ma i ri, me motrën e juv po m'doket keni shku nëpër fshatra me fotografu...

Dilaver Pepa: Po, po, po. E, dyqanin unë kom fillu, thashë, pesë-gjashtë vjeç kom dalë n'dyqan me pastru e me... me iu ndihmu diçka, si fmija që ka qejf gjithkrah me u përzi. E, motra atëherë punojke, Liria... ka qenë një ndër, po mendoj baba, po baba veç filloi me e lshu kapak-kapak motrave me udhëheq me dyqan, kështu dy motrat, Liria dhe Mersija. Edhe unë si, faktik... atëherë i thojshim shegërt², me e pastru dyqanin n'mëngjes... atëherë s'janë kanë kushtet me kanalizim, me ujna e me kto... me mbushë ujë e... se uji në fotografi osht' i pastër... i zavendsushëm. E kështu që, tonë jeta m'ka shku, thashë ma herët pak asi, ma tepër n'dyqan se që kom ndejtë me lujtë nëpër mahallë me shokë. Kur jom bo dikah 14-15 vjet atëherë veç kom fillu me msu.

E t'kthehna në pytjen që m'pytët për fshatin... i kom pasë nëntë vjet, dhjetë vjet s'po di tash pak ma asi... E u bo ndryshimi i lejenjoftimeve. Në fshatrat në Dukagjin pak ish problem gratë me ardhë me u fotografu e... a din, situata ka qenë e tillë pak... pak a shumë. Edhe erdh një... kryefshatari i Prilepit sa m'kujtohet, nifarë Dulje, i kanë thanë. Edhe me babën tu bisedu... kjo ka qenë vitet '69-ta, '68-të... s'po di tash tamon a din mos... "A mundeni me ardhë me fotografu?" Ai e ditke që motra punon asi edhe u murrëm vesh, me babën, me motrën... edhe shkumë unë e motra. Unë isha fëmijë, unë me ia mbajtë jo mrpavijën, jo diçka me i ndihmu.

Edhe fillumë prej fshatit Prilep, kështu që krejt fshatrat e Dukagjinit, me Prilep e tuj ardhë kah Deçani e... Strellci e këndej... këndej anën tjetër kah Prishtina, Zahaqi e kto që i kem fotografu. Ka qenë një punë bajegi e madhe atëherë, a din, krejt fshatrat e Dukagjinit, për dokumente, për leje të njoftimit. Edhe punë e madhe edhe... edhe ka qenë materialisht interesant se o fitu mirë atëherë. M'kujtohet si sot një televizion... atëherë sa patën dalë televizorat. Kjo motra me qato, "Hajt be abej", tha "qe merre ni dhuratë bleje ni televizion". Se atëherë as televiziona s'kish faktikisht, jonë kanë shumë t'rallë. E kjo...

Anita Susuri: A ju ka ndodhë diçka, për shembull që... interesante ose...

Dilaver Pepa: A interesante aty gjithçka kem pa atëherë, fshatrat nuk kanë qenë si tash t'zhvillumë. Kur hijshim, që iu thojnë tash maxhe³ qaty qe e përgatitshin ushqimin, qaty qe ishin... Interesant shumë ka qenë po, a din, mos... n'detaje tash mos t'hi.

Anita Susuri: A e vërejtsh, për shembull dallimin qytet edhe fshat? A ka qenë dallimi i madh?

Dilaver Pepa: Ou me të... po, dallimi ka qenë me t'madhe ka qenë se... atëherë fshati ka qenë shumë i lanun mbas dore, po mendoj, vendbanimet, ku kanë jetu. Janë kujdesë ma tepër për bujqësi, për

² Çirak, djalë i vogël që bënte punë ndihmëse në dyqan.

³ Vend ku mbahej mielli dhe gatuhej.

blegtori, kështu që jetës pak i kanë kushtu [rëndësi]. Kanë qenë, sa m'kujtohet mu tash, kulla ose shtëpiat ku kanë jetu t'ndame, do për gra, do për burra, ku kanë hongër, ku kanë pi, që kanë përgatitë s'bashku aty... e kështu. Interesant m'u ka dokë shumë. E në qytet ma ndryshe, a din, jonë kanë kushtet pak ma të mira, ma asi... Po msohet njeri, adaptohet, a din, tu e pa tana m'u dokke rutinë e saj, m'u dokke njejtë.

Anita Susuri: Çfarë materiale keni përdorë atëherë për me i zhvillu fotografitë? Qysh ka shku kjo punë? Ku jonë gjetë ato materiale?

Dilaver Pepa: Atëherë, në atë kohë, po mendoj, s'ka pasë në Kosovë që kanë punu me kemikale, me kto... jem furnizu zakonisht prej Zagrebit. Atëherë ka qenë një ndërmarrje i thojshin Foto-teknika... Fotokemika, ku prodhojshin ata i... kemikalet. Ato kanë qenë zhvilluesi, fiksiri, faktikisht zbardhuesi i thojnë tash... (gogësin) m'falni... letra t'ndryshme, filmat, fotokemika. Kështu që, atje shkojshim me u furnizu. Prej viteve dikah të '70-a fillunë e bonën një përfaqësi në Shkup, Fotokemika e Zagrebit. Kështu që, shpesh na ka ra me motrën Lirijen qato me shku në Shkup, me u furnizu me material. Ai ka qenë zhvilluesi, ka qenë zbardhuesi, letra, filmat.

Atëherë filmat kanë qenë ndryshe, nuk kanë qenë si... ju jeni të reja s'di sa e mbani n'mend, filmat rollne, po kanë qenë filma t'xhamit, seta. Kështu që bajegi problem o kanë me u gjind po... kur e vazhdon ni punë që e don, atëherë veç gjindesh. Puna n'foto... n'dyqan ka qenë bajegi e vështirë. Tash fotografimi që u bojke, mas fotografimit u duhke me i marrë qato, qat' film me e zhvillu. U zhvillojke filmi edhe aty tash e kishe një, që thojmë na, një stres... bon vaki i ka mbyllë sytë. Se ti nuk e sheh si tash që... në dixhital, në telefona, "Fotografonu... o sytë". Prishe, ndale, fshije. Kështu që, edhe ajo o kanë njëfarë stresi.

Dalke mirë, atëherë u duhke me u tha ai film. U thajke mirë edhe e shtijshim n'aparati. N'aparati u duhke tash letrën, a din s'di... me ju shpjegu tash o bajegi një procedurë. Letra hin përfundi, aparati lëshon rrezet e dritës nëpërmjet qatij filmit edhe inkorporohet ajo fotografia aty. Prej atyhit e merr fotografinë edhe e shtin në zhvillues. Krejt kto që po folim bohen në komorën [dhomën] e errët. Osht' ni dritë e vogël, e kuqe sa me pasë orientim pakëz. Zhvillohet fotografia aty. E sheh që e ke fitu ato çka po lypë edhe shtihet n'zbardhues m'u ndërpre procedura e zhvillimit, se nëse e lojmë pak ma tepër ajo nxihet, prishet. E qet n'zbardhues. E len aty një kohë, një orë, dy orë, tri orë, varësisht edhe shpërllahet mirë. Mbas shpërlarjes, merret fotografia.

Është një send interesant që njerëzit nuk e dijnë. Ne fotografitë përpara i kem terë n'xhama. Një xham për shembull ka qenë një metër me gjysë metre edhe atë xham e kem pastru shumë mirë, e kem... faktikisht me pudër që përdoret për fmijë, e kem qitë për me mujtë me vizllu xhami, mirë. Edhe fotografitë e lagta i kem renditë n'xham. Me gazeta, i kem pasë do si *valjaka* [Srb. rul], i thojshin, gazeta për me ia marrë ujin. Kur e merrshim ujin, u shihke edhe i lejshim xhamat afër, ose dikah nxehtë ose... verës jashtë i lejshim n'shtëpi. Prej nxehtësisë, diellit... edhe ato u tershin, u tershin, u tershin edhe vishin n'to fotografitë e gatshme. Kështu që ka qenë një procedurë... tana dikur ma vonë dulën maqinat me rrymë. Ishte... ishin... i kanë pasë pllakat aty, u tershin, i nxirrshim.

Anita Susuri: Deri n'cilin vit keni vazhdu me këtë procedurë?

Dilaver Pepa: Me këtë procedurë kem vazhdu valla deri n'vitin... tash në të '74-tën unë kom ardhë. Faktikisht deri në të '74-tën, jo... '78-'79-tën... '80-ën kanë fillu veç fotografitë *color* [Ang. me ngjyrë]. Po mendoj te na se ato kanë fillu pak ma herët. Ka zgjatë bajegi ni kohë valla, a din, s'po m'kujtohet tamon viti deri kur veç... m'kujtohet '85-'86 i kem ble maqinat e para faktikisht. Kanë qenë për fotografi kolor. Atëherë i thojshin fotografi t'terme, se dalin krejt t'gatshme, prej sistemit... prej fillimit deri n'fund veç fotografinë e nxirr t'terme. Vllau, Skenderi, i patë kontaktu... do maqina në Gjermani. Erdhën maqinat. Kështu që filloi... periudha e kolorit.

Anita Susuri: Qajo periudha për me dalë n'foto sa ka zgjatë? Derisa sa osht?... produkti final ka dalë...

Dilaver Pepa: Tash t'kthehna pak ma herët asi ni kohë. Qysh kom fillu unë ma s'pari asi... për me e përvetësu zanatin. Ish e dille edhe t'dilleve zakonisht delshim me e pastru dyqanin. Atëherë kanë qenë podnat prej drasave, i lyjshim me vaje t'ndryshme, a din, për pastërti. Ndërkohë, erdh një myshteri, t'dilleve s'punojshim, m'u fotografu. Unë tash... s'po m'kujtohet a i kom pasë dhjetë a dymbëdhjetë vjet a asi. Tha, "Po du me o fotografu". Thojsha qysh me e fotografu e i vyjshin fotografitë për shpejti. Edhe unë e morra guximin thashë hajt po provoj, që bohet diçka e thirri ja motrën, ja babën edhe i tregoj. E morra, i kem pasë do aparata *light*⁴. Ata kanë qenë atëherë aparata sa shuplaka e dorës që ka qenë. E vendosshin filmin... filmin... veç fillunë filmat me dalë me rrollne. E vendosshim filmin... e fotografova. Edhe tash atij po i thom, "Eja mas njo një ore, mas një ore e kqyrim çka me asi". Shkoi ai, e fotografoj unë. Edhe hi e këpus filmin shpejt. Ajo një copë e filmit të vogël edhe e zhvilloj. Edhe për mrekulli pata, dul mirë. Kështu që, prej atëhershit fillova unë zanatin me e marrë me t'madhe. E pastaj veç fillunë me m'jep detyra pak ma asi që mujsha me punu diçka si ma thjesht...

Anita Susuri: Sa kohë i ka vyjtë për shembull...

Dilaver Pepa: I ka vyjtë... fotografisë një zhvillim. Për shembull, një lamje e filmit ka zgjatë pesë-gjashtë minuta. Po tash është procedura e terjes, deri sa o terë, aty ka marrë bajegi kohë nëse s'ke pasë... atëherë s'ke pasë as fena m'i terë për shembull. Po o duhtë në nxehtësi dikah afër stufës a diçka nëse o kanë dimri. Nëse vera, jonë dalë n'dielli pak me asi. E procesi i fotografisë... edhe aty punimi ka zgjatë nja gjysë ore... zhvillimi, pastrimi, terja. Kështu që, para njo një ore, po mendoj, një fotografi të thjeshtë me e bo, para një ore, dy ore, vështirë ka qenë me u bo e...

Na zakonisht e kem pasë i bojshim fotografitë gjatë ditës. N'mramje i merrshim n'shpi edhe n'shpi... ma herët që e shpjegova ato me xhama... e i... n'mramje i qitshim i tershim. Në sabah kur u çojshim, i merrshim fotografitë që kishin ra prej xhamave, veç i mledhshim edhe [shkojshim] n'dyqan. Kjo ka qenë një procedurë. Unë faktikisht kom punu deri në '81-tën në dyqan. Kështu ka qenë... se në '74-tën kjo motra ka ardhë në Prishtinë, e thirrën në Fakultetin e Mjekësisë me punu si fotografe. Mbetëm unë,

⁴ Edicion i aparatit fotografik i formatit të vogël dhe të lehtë.

motra edhe vllau. Motra ka qenë Mersija e dyta, vllau edhe unë në dyqan. Unë '78-tën jom shku ushtar, në '79-tën e kom kry ushtrinë, të '80-tën në dyqan, '81-tën jom ardhë n'punë në Prishtinë.

Anita Susuri: Para se me vazhdu aty, veç edhe një pyetje e kom lidhur me dyqanin në Pejë. Atëherë, a ka pasë shumë kërkesa për me u fotografu edhe... thatë për letërnjoftime e për...

Dilaver Pepa: Po...

Anita Susuri: ...dokumentacion po edhe për... për çka tjetër kanë ardhë njerëzit me u fotografu?

Dilaver Pepa: Përveç për dokumentacion, kanë ardhë fotografi... me bo fotografi t'fejesave t'ndryshme, besa edhe t'martesave se atëherë s'kanë shku nëpër dasma me fotografu, po mbasi janë martu janë ardhë, zakonisht janë ardhë krejt familja. S'di ma herët e ceka, bajegi ceremoni ka qenë me u fotografu. Jonë duhtë një javë ditë përpara m'u përgatitë, teshat m'i ble... se nuk jonë shku me tyllifare tesha me u fotografu. Kështu që, ka qenë një procedurë bajegi... dyqani ka qenë... e ka pasë atelien e vet. Kështu që, janë ardhë burra, gra, fmijë, krejt familja jonë fotografu. Ka qenë një punë e mirë, a din, nuk ka pasë qaq punë shumë t'madhe, po një jetesë e mirë.

Pastaj e kem pasë... ushtria... atëherë kanë qenë kasarnet [Srb. kazerma]. Edhe zakonisht ata delshin të shtundeve, të dilleve, ushtarët. Edhe mu duhke me dalë se vishin me u fotografu... kanë pasë një kujtim prej ushtrisë. Atëherë i marojshim fotografitë... e ka pasë një shabllon... serbisht ka qenë për shembull, ça po di unë, "Kujtim nga armata popullore e Jugosllavisë" atëherë. E mjaft ka pasë, a din, të shtundeve, të dieleve punë me ushtarë. Pastaj baba përpara dilke edhe nëpër... në Pejë ekziston një park i madh, park i bukur, Karagaç i thojnë, ka qenë shumë park i bukur. Të dilleve e thirrshin me fotografu familje në park tu u shetitë dilshin... kështu që kjo ka qenë ajo puna. E amater, që i thojmë na, për shembull që janë fotografu vet, ajo vonë ka fillu pak ma asi... kushtet nuk kanë qenë me pasë aparat atëherë. Po, kohë pas kohe fillojnë edhe aparatat, filmat, fillon puna me amaterë të ndryshëm e kështu.

Anita Susuri: Ju n'shkollën e mesme, në cilën shkollë keni qenë?

Dilaver Pepa: Në gjimnaz "Sami Fr... "11 Maji", tash "Bedri Pejani". Ajo ka qenë një shkollë... një rast m'kujtohet erdhën prej Shqipnisë do pejonë që kishin ikë po edhe kishin arritë me u kthy ktu. Atëherë Shqipnia ka qenë... unë e mbaj mend pakëz kështu prej kujtimeve, prej bisedave... gjimnazi i Pejës ka qenë n'atë kohë si me e kry ndonjë fakultet dikah, qaq ka qenë, a din, shkollë e fortë për ka arsimit, për ka profesorat besa edhe nxanësit. Kanë qenë pak ma si t'fortë se tash, po foli për situatën e tashme. Unë jom pak kritik, a din... janë çelë shumë shkolla, po kualiteti jo fort... e prej gjimnazit '73-'74 kom regjistru Fakultetin Juridik...

Anita Susuri: Në Prishtinë?

Dilaver Pepa: Ktu në Prishtinë. Faktikisht, unë prej '74-tës jom në Prishtinë, me disa ndërpreme. '78-tën ma herët e ceka kom shku ushtar, atëherë ish-Jugosllavi, në '79-tën e kom kry. Fakultetin e lashë pak mbas dore, në dyqan prapë m'u dukte m'u kthy me ndihmu, me punu... deri në '81-shin. Në '81-shin kom ardhë në Prishtinë. Jom...

Anita Susuri: Në '81-tën jeni vendosë domethënë përfundimisht në Prishtinë...

Dilaver Pepa: Në '81-shin...

Anita Susuri: Me dyqan...

Dilaver Pepa: Po me... jo, n'punë në '81-shin. Në fakt është një ndërlidhje lidhet me demonstratat. Me 1 prill, '81-shin kem fillu punën kur na kanë thirrë. Qat' ditë kanë qenë demonstratat shumë masive në Prishtinë. Në '81-shin po vij edhe faktikisht në Dardani qetu afër ish... dyqani ku e kom tash, po i shoh autobusat rend, ishin renditë. Edhe vetmeveti po mendoj, po thom, "I pari, zaherë po i marrkan rrogat punëtorët, Ramiz Sadiku". Kur i kom bo edhe disa hapa ma kënde, kur e kom pa turmën e demonstratave, atëherë veç... dihet '81-shi ka qenë... demonstratat masive në Prishtinë, me 1 prill, me 2 prill... na qat' ditë kem startu n'punë, që m'kanë thirrë në Muze të Revolucionit⁵.

Anita Susuri: Çka keni pa hala... a ka pasë shumë policë, dhunë... çka ka pasë?

Dilaver Pepa: A çka s'ka pasë. Ka pasë policë shumë... masa ka qenë qaq e madhe që... as policët nuk janë pa qaq shumë masi prej masës. Po kur fillunë me gjujtë me *suzavac* [Srb. gaz lotsjellës], me gjujtë besa me plumba përnime, atëherë veç u bo pak ma tepër panikë. Njerëzit fillunë me ikë, me asi... Unë erdha, m'u dukte me e gjetë banesën e motrës, se Liria veç ishte e vendosme ktu në Prishtinë në të '74-ën. E disha, kom qenë disa herë, po n'atë tollovi njeri edhe hutohet pak. Por e gjeta banesën, shkova. Tana mo nuk muna me dalë. Nejse kureshtja ime ishte me dalë me pa ça po ndodhë, tek po ndodhë, a din, po s'më lanë me dalë atë natë, se ato kanë zgjatë deri vonë natën, demonstratat.

Të nesrit kishim me u lajmëru, me 2 prill, kishim me u lajmëru tash n'punë. Faktikisht një mbledhje drejtori, ish-drejtori, Muhamed Shukriu⁶ na patë thirrë. Po situata ish... derisa dola prej banesës, atëherë jetojke... jetojshim te rrethi, e mbledhjen e kishim te stadioni i Prishtinës. Aty ka qenë Bashkësia e Kulturës⁷, aty një mbledhje na thirrën. Rrugës, xhamat e thymë, automob... kerret e

⁵ Muzeu i Revolucionit veproi gjatë periudhës së ish-Jugosllavisë, mandati i së cilës ishte hulumtimi dhe ekspozimi i historisë që lidhej me Luftën Nacional-Çlirimtare. Si i tillë u shpërbë në vitin 1992 dhe nuk ekziston më. Muzeut i Revolucionit ishte i vendosur në ndërtesën e Galerisë së Arteve të Kosovës.

⁶ Muhamed Shukriu (1926-2010) ishte profesionist i trashëgimisë kulturore dhe historike të Kosovës, drejtor i Entit për Mbrojtjen e Përmendoreve Kulturore të Prizrenit dhe ideator i Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

⁷ Bashkësia e Kulturës apo BVI-ja për Kulturë, të cilës i referohet folësi ka qenë institucion që është marrë me çështjet kulturore në Krahinën Autonome të Kosovës. BVI - Byroja Vetëqeverisëse e Interesit përbëhej nga agjenci të ndryshme qeveritare, të cilat ishin ekuivalente me ministritë.

thyme, prej policisë gjithkrah t'gjyjtme. Po, {ngre supet} ka qenë kaos, kaos i madh, kështu që fillumë kadal-dale me punu.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Para se me vazhdu për punën në Muze, deshta edhe me ju... me ju pytë për Prishtinën qysh ju është dokë në atë kohë. Qysh ka qenë Prishtina edhe qysh e keni kalu kohën në Prishtinë?

Dilaver Pepa: Unë Prishtinën e mbaj mend prej '74-tës. Prishtina ka qenë, ka qenë e bukur por jo si... ka qenë shumë ma pak e zhvillume. Tash me ju jep një shembull, për shembull në Kalabri të sotit me thonë, "Banoj atje". "Nuk koke në Prishtinë, se koke shumë larg". Bregu i Diellit ka qenë hata si... na banojshim me shokë si studentë mbi menzë të studentëve aty. Edhe ajo ka qenë lagje e largët. Po kohë mbas kohe, Prishtina u zhvillu, u zhvillu. Fillunë kafiqat, fillunë studentët e bonën jetën shumë ma interesante. Atëherë ka pasë shumë studenta.

Faktikisht flitet në atë kohë '74-'75, që 40-50 mijë studenta kanë qenë. *Dome* [Srb. konvikte], kanë qenë nja tre *dome* të studentave. Kështu që edhe atë periudhë e mbaj mend se kom jetu një vjet në *dom* [konvikt] të studentave. Jeta si jetë ka qenë e mirë, ka qenë ma modeste se tash po... Unë shpesh e përmendi, ma shumë je teshë [takuar] me shokë... atëherë s'ka pasë telefona, s'ka pasë kurgjo hiç. Je marrë vesh kur me dalë kur m'u teshë se sot që i ki kah dy telefona nëpër xhepa edhe... Kështu që, ka qenë një jetë e mirë, shumë e mirë. A din, na kapë kaheerë nostalgjia për atë kohë, po jeta vazhdon.

Anita Susuri: A ka pasë atëherë edhe ngjarje kulturore, për shembull ka qenë Kino Rinia, ka qenë edhe teatri. A i keni vizitu këto, a keni naj kujtim prej...

Dilaver Pepa: Me ju thonë të drejtën, jeta kulturore ka qenë ma e zhvillume për mu sa m' duket se tash. Teatri ka funksionu për mrekulli. Çdo ditë, faktikisht, bon vaki çdo ditë, mos t'thom për çdo t'dytën, t'tretën ditë ka pasë pjesë të teatrit... po, kom shku. Kinemaja, kanë ekzistru tri kinemaja atëherë: Kino Vllaznimi, ABC-ja. Te Kino AB... Vllaznimi që osht' atje te Qafa, kanë qenë dy kinemaja, njo nalt, njo poshtë. Teatri... nejse mos t'foli për jetën sportive. Atëherë futbollit ka qenë n'atë kulmin ma t'madh, [Klubi] Prishtina. Krejt Kosova vijke në Prishtinë për me e pa Prishtinën. Hini n'ligë t'parë të Jugosllavisë, të ish-Jugosllavisë. Kështu që, jeta ka qenë si në kulturë, si në sport, ka qenë pak ma dinamike bar⁸... a din, ndoshta unë kam qenë atëherë ma i ri e më duket.

Anita Susuri: Në kinema çfarë filma ka pasë edhe sa shpesh, për shembull, brenda javës keni shku?

Dilaver Pepa: Kinemanë e kom përcjellë shumë. Kështu që kem shku shumë shpesh, a din, sa na ka leju koha, kushtet materiale. Filmat u jepshin atëherë... ma së shumti që janë jepë filmat, janë jepë

⁸ Shkurtesë e "barem", në kontekstin aktual merr kuptimin e "madje".

filmat *Western*⁹. A din me John Wayne¹⁰ e me do artista t'vjetër. Pastaj fillunë jo James Bond, Sean Connery¹¹. Këta me lujtë... zhanreve t'ndryshme, po neve si t'ri ma s'shumti na pëlqejshin filmat aksion ose kauboj... ksi *Western* që i thojnë, e kështu.

Teatër atëherë qato pjesë që u jepshin, shumicën, mos t'thom të gjitha, veç shumicën i kem përcjellë. Unë edhe në Pejë i kom pasë do shokë që jonë marrë me teatër, kështu që e percjellshim mjaft. Tana edhe kur kem studiu në Pejë kanë qenë artistat, Astrit Latifi, Zija Bala, Lushi në teatër të Pejës. Kështu që, a din, prej atëhershit na ka mbetë edhe kem vazhdu në Prishtinë, po mendoj, si vizitorë, si... m'i përcjellë këto ngjarje.

Anita Susuri: Thatë që n'vitin '81 keni fillu punën në muze. Muzeu po m'doket prej vitit '56 ose '59 e ka pasë për Luftën Nacional-Çlirimtare, atëfarë departamentin.

Dilaver Pepa: Po.

Anita Susuri: Ju kur keni fillu punën, qysh ka qenë edhe çka ka qenë roli i juaj? Çka keni... e di që domethënë profesioni ka qenë fotografimi edhe ky ka qenë roli juaj, po çka keni fotografu ma shumë?

Dilaver Pepa: Në '81-shin kur kom fillu me punu, unë kom fillu si fotograf, bashkëpunëtor profesional për fotografi. Muzeu si muze veprimtarinë... Muzeu i Revolucionit u qujke, i Kombeve, Kombësive të Kosovës, veprimtarinë kryesore që e ka pasë... i ka përcjellë tri periudha: periudhën para luftime, mbasi luftime, luftën... faktikisht Luftën Nacional-Çlirimtare '41-'45 edhe zhvillimin socialist... qeto tri periudha i ka përcjellë. E veprimtaria kryesore që atëherë o bo, o bo me ekspozita. Mbasi Muzeu i Kosovës ka ekzistuar, po aty kanë punu serbët, një pjesë e madhe kanë qenë serbë, që kurrë nuk janë marrë me këtë veprimtari. Ish-drejtori Muhamed Shukriu ka pasë një vizion t'mirë, po mendoj, ai e themeloi muzeun e... veprimtaria primare kanë qenë ekspozitat. Ekspozitat, atëherë nuk kishim kushte me e bo një ekspozitë t'përhershme, po ekspozita tematike, tash varësisht prej temës.

Në... koha e turqve, Lufta Nacional-Çlirimtare edhe zhvillimi socialist. Nëse e bojshim për shembull një ekspozitë të Luftës Nacional-Çlirimtare, ajo e përfshijke periudhën '41- '45 për partizanët e Kosovës. Me ato ekspozita, përveç që shëtishim nëpër Kosovë, krejt qytetet e Kosovës, delshim edhe jashtë Kosovës. Jo në Serbi, jo në Bosnjë, jo në Mal të Zi, kto vende. Kështu që, e kem shëtitë bajegi mirë me ekspozita. Ndërsa periudha Ndërtimi Socialist ka qenë përcjellja e ngjarjeve ditore, jo të gjithat, po ato që kishin një peshë pak ma të madhe historike. E situata atëherë nuk ish besa e mirë.

Mas '81-shit dihet ka qenë gjithmonë... përcjellja, çka po punon, tek po punon. Unë i kom pasë do shokë, faktikisht, shokë shumë të zotë, historianë, që nëpërmjet ekspozitave t'ndryshme i kanë qitë do dokumenta që kurrë nuk o ditë për ta për shembull. Mu m'kujtohet për Luftën Nacional-Çlirimtare kur

⁹ Filma rreth jetës në Amerikën perëndimore gjatë shekullit XIX, posaçërisht rreth jetës së kaubojëve.

¹⁰ Një aktor i njohur amerikan i filmave *Western*.

¹¹ Aktor skocez dhe i pari që luajti rolin e agjentit sekret britanez James Bond në film.

e qitën një dokument atëherë, tregojke ky Mehmeti [Gjoshi]¹² thojke, “Ky o ni dokument për Mbledhjen e Bujanit”, në ‘42-tën kur e kanë mbajtur. Edhe n’atë dokument ceket çka ka me ndodhë me Kosovën faktikisht, kundërshtimet e serbëve e... këto parimet e shqiptarëve që lypshin, qato të drejta që asi. Edhe për t’parën herë, si dokument e vendosin në ekspozitë. U kanë bajegi problem, erdh Komiteti Krahinor atëherë, qysh e keni qitë e tek e keni qitë e...

Por, nëpërmjet qetyne sendeve u mendojshin me e vendosë dikah me e pa kush jem, tek jem. Roli im si fotograf ka qenë bajegi i madh, a din, s’po du veten me e asi veç (qesh)... o duhtë... mbledhja e fotografive që janë mbledhë prej bashkëpun... prej historianëve, nëpër vende të ndryshme, prej njerëzve, prej luftëtarëve. Ato fotografi me i marrë, me i reproduku. Atëherë ka qenë bajegi proces reprodukimi i fotografive se s’kanë ekzistuar skanerat apo pajisjet siç janë tash. O duhtë qato fotografi me i reproduku. Prej atyhit, m’i punu fotografitë. O duhtë me punu fotografi për dokumentacion. Edhe qato fotografi negative, ato u ruajshin që nesër-masnesër kur vendosshin me bo farë ekspozite, m’i marrë edhe me i punu fotografitë të formateve të mdhaja.

A din, m’kujtohet kom punu fotografi të madhësisë dy metra me një metër e gjysë, na kanë vyjtë tri fotografi... atëherë ish-kryetarit të Jugosllavisë Titos, me e bo një ekspozitë për 25 maj, ditën e ditëlindjes që u festojke atëherë. Kushtet s’i kisha në Muze, megjithëse zyrën unë e këto laboratorin e kisha, po jo për aq fotografi t’mdhaja. M’u duhtë me shku në Televizion të Prishtinës, atje i kanë pasë do korita t’mdhaja. Se fotografia në rollne të madhe u duhke bajegi vend i madh, hapësinë, atje i kom pasë punu. Kështu që, 80 përqind kom punu me ekspozita. Por, Ndërtimin Socialist mbas luftës... faktikisht krejt Kosovën e kem shëtitë, tu i fotografu fabrikat, prodhimet në fabrika, si punohet. Faktikisht ne... me pa që Kosova osht’ ndërtu shumë mbas luftës. Sa ka qenë ajo reale... (qesh)

Anita Susuri: Çfarë eksponate ka pasë? Ju sigurisht edhe eksponatet i keni fotografu?

Dilaver Pepa: Po, po. Varësisht çka kanë gjetë. Këta historianët kur kanë shku, për shembull si ekipë kem shku, tre-katër vetë. E nëse ka pasë farë eksponati, po folim për pjesëmarrësit e Luftës Nacional-Çlirimtare, dikush ka pasë farë revole, fotografi t’ndryshme, apo diçka që iu ka shërby atëherë gjatë kohës. Nëse kanë qenë në dispozicion, na kanë falë, ia kanë falë Muzeut faktikisht edhe ato janë marrë janë prue në Muze. Nëse kanë vyjtë me u konzervu, jonë konzervu edhe jonë rujtë n’dokumentacion, që nesër-masnesër me u ekspozu. Atëherë gjithmonë mendojshim për një ekspozitë të përhershme, po situata ka qenë atëherë... prej ‘81-shit neve na percjellë një, një fat jo fort i mirë... një situatë politike... shqiptarët kanë qenë gjithmonë të përndjekun. Kjo ka qenë periudha e atëhershit, ju s’e mbani mend s’keni qenë ndoshta as t’lindun, po në përgjithësi ka shku, ka... osht’ punu me ato mundësi që kem pasë.

Anita Susuri: E në... eksponatat e periudhës para luftës... çfarë kanë qenë? Çka ka pasë ma shumë?

¹² Mehmet Gjoshi (1949-2018) ishte historian i shquar nga Drenasi dhe autor i disa studimeve dhe publikimeve mbi historinë e Kosovës, dhe bashkëpunëtor në Muzeun e Revolucionit.

Dilaver Pepa: Na si Muze, faktikisht, nuk e kem pasë arkeologjinë, kështu që, pajisje [objekte] ksi të... arkeologjike s'kem pasë. Ekspozitat 80 përqind që kanë qenë në Muze të Revolucionit kanë qenë armatime të ndryshme. Me... çka po di unë, me thika, shpata, armë të ndryshme, se për arkeologji ka ekzistuar Muzeu i Kosovës, por ka funksionu shumë pak, shumë dobët. Na e ngjallëm pak jetën, në... në Kosovë, po mendoj, n'anën e muzeologjisë e faktikisht çdo muaj bojshim ka një ekspozitë. Vijnë shkollat, organizojshin shkollat me ardhë me i vizitu ekspozitat. Kështu që, u bo një... neve na jepën... atëherë ka qenë ish Biblioteka Kombëtare. Ata dulën n'institucionin e ri ku është sot Biblioteka, neve na jepën ndërtesën e tyne, që qat' ndërtesë i ndjeri Agush Beqiri¹³ e pat'... arkitekturën e pat' bo edhe ia përshtatëm muzeologjisë. Kështu që, e kem pasë një sallë poshtë t'madhe për ekspozita. Faktikisht, sot është Galeria e Arteve, hala është qajo sallë. E kështu ka qenë ajo jeta e muzeologjisë.

Anita Susuri: A ka qenë staf i madh?

Dilaver Pepa: Kur kem startu, kem qenë dikah nja 15 vetë. Kanë qenë historianë, zakonisht kanë qenë që i kanë përcjellë dy-tre historianë periudhën e kohës së turqve, dy-tre historianë kohën e Luftës Nacional-Çlirimtare '41-'45 edhe dy-tre e kanë përcjellë zhvillimin socialist pas lufte. Unë kom qenë si fotograf... i kem pasë dy artista. Ata kanë punu, normal, me aranzhimin e ekspozitave se bajegi ka qenë punë... ato ekspozita u duhtë me i vendosë, u duhtë m'i aranzhu. Fatmir Hoxha, Osman Mejzinolli, këta kanë qenë dy artista në akademi. Kem pasë një depoist, një... edhe shërbimi administrativ, arkatar e këto, drejtorin Muhamed Shukriun e kem pasë, po faktikisht ata e hekën shpejt mas tre-katër muajve. Tana fillunë me drejtorin t'ri e qeshtu.

Anita Susuri: Që përmendët çdo muaj që ka pasë ekspozita, aq shpesh ka pasë ekspozite t'reja që jonë bo ekspozita, apo ka pasë kërkesë t'madhe?

Dilaver Pepa: Jo kërkesë që ka pasë, po, faktikisht ekspozitat i bojshim sipas ngjarjeve, farë date që u lidhke, për shembull 25 maji, po ja lojmë dita e... atëherë...

Anita Susuri: Rinisë.

Dilaver Pepa: Titos, po, ditëlindja e Titos, e bojshim ni ekspozitë. Mbas disa kohe tjetër dilke një datë tjetër, një përvjetor i një brigade, për shembull i Luftës Nacional-Çlirimtare, e bojshim një ekspozitë. Vijnë farë hapje e fabrikës a zhvillimi ekonomik diçka, një ekspozitë. Kështu që, temat gjithmonë kanë... Lidhja e Prizrenit për shembull, e bojshim një ekspozitë, po sa m'lejojshin atëherë rrethanat se ishin serbët ata që gjithmonë rrijshin mbi kokë, çka po qet, tek po qet... E kështu që, ndoshta s'ka pasë për gjithë n'mujë veç n'vjet janë kanë dy-tri ekspozita ma s'pakti. E ato ekspozita janë vizitu mjaft mirë. Ka do që kanë shku, Kosovë, besa edhe jashtë kanë shku, nëpër Serbi, Mal të Zi... në Kroaci kem pasë qenë. Në Shqipëri atëherë s'kem shku hala, se ish situata pak ma...

¹³ Agush Beqiri (1932-2006) i lindur në Pejë, Kosovë, ishte arkitekt, artist dhe dizajner i enterierit.

Anita Susuri: A ka pasë edhe vizita prej njerëzve ma, si me thanë, që kanë qenë në krye të institucioneve?

Dilaver Pepa: *Auff* {onomatope} Çdo hapje e ekspozitës patjetër o ardhë dikush, po atëherë politika ka qenë ngryçi [ngërçi], jonë duhtë Kryetari i Komitetit, a çka po di unë. Ata kanë qenë patjetër aty në hapje. Faktikisht iu ka kushtu roli kryesor... ata me e bo hapjen e ekspozitës. Kështu që, gjithçka ka qenë me program të caktum që... po, jom mundu, si unë, si këta shokët e mi, që kanë punu historianët, jom mundu gjithmonë me ia përshtatë pak kohës, a din, historinë. Unë e kam ni moto, “Historinë e shkrun ai që fiton, po e shkrun qysh ka qejf, jo qysh ka qenë” (qesh). Kështu që...

Anita Susuri: Ju edhe këto i keni fotografu a po?

Dilaver Pepa: Shumicën e ngjarjeve, po mendoj, mbas luftës atëherë prej ‘81-shit. Çdo manifestim faktikisht kem shku. M’kujtohet tash në ‘89-tën kur u bonë... këto protestat e minatorëve.

Anita Susuri: Grevat, po.

Dilaver Pepa: Atëherë e kishim drejtor Shefki Stubllën. Unë edhe qeky Mehmeti, Mehmet Gjoshaj edhe Riza Sadiku¹⁴ shkumë te drejtori edhe po kërkujmë... atëherë krejt Kosova u çu në përkrahje të minatorëve. Edhe tash na si Muze mos me e përcjellë si ngjarje, a din, u dokke... megjithëse, serbët s’kishin qejf na me e përcjellë atë ngjarje, se ish... edhe shkumë te drejtori, p’i thojmë, “Qeshtu, qeshtu, po dojna me shku”. Ai drejtori pak u frigu, “Paj qysh e tek e situata”, tha, “po, ani shkoni” e asi edhe na shkumë. Shkumë n’minierë në Staritërg, hinëm. Na lejunë me hi, fotografumë. Ato edhe sot e atë ditë ekzistojnë... sa ekziston se unë e kom lëshu në ‘92-‘93 e kom lëshu Muzeun. Janë në arkivë, të fotografume. Disa fotografi i kom pasë edhe unë, po... (qeshë) ka qenë interesant jeta atëherë, me vështirësi...

Anita Susuri: Ata... në grevën e minatorëve domethënë... kur ka qenë greva, minatorët... kanë qenë disa minatorë që e kanë përcaktu kush lejohet me hy brenda edhe kush jo, për shkak se nëse e kanë leju dikond, ka mujtë me bo propagandë apo diçka...

Dilaver Pepa: Po, po.

Anita Susuri: Juve ju kanë leju edhe a mundeni me ma përshkru si ka qenë qajo hyrje se ajo është shumë metra thellësi. Qysh ka qenë për juve ai përjetim?

Dilaver Pepa: Na si punëtorë të Muzeut kem qenë edhe ma herët e kemi vizitu minierën, po jo në atë thellësi. Atëherë ka qenë, faktikisht, kur o mbajtë kjo greva e minatorëve, horizonti i dymbëdhjetë. Veç me mendu me zhdrypë ka qenë bajegi vështirë. Neve na kanë leju... na i kishim autorizimet prej Muzeut, pak a shumë na njifshin... edhe na lejunë me hi. Edhe na jem frigu që s’na lejojnë me hi, se aty

¹⁴ Riza Sadiku (1949-2019) i lindur në Kërçovë, Maqedonia e Veriut, ishte historian i shquar dhe kontribues në Arkivin e Shtetëror të Kosovës dhe këshilltar profesional i muzeologjisë në Muzeun e Kosovës.

ka mujtë gjithkush me hi, ka mujtë... atëherë ka qenë propaganda serbe e madhe qaq shumë që s'ke ditë prej kahit po t'vjen. Po na lejunë, hinëm.

Aty ka qenë një masë e madhe e minatorëve, të ngujumë ishin, a din, mjerim me i pa. Përveç që je qaq poshtë, po foli prej përvojave t'mia që u frigojshim, ajri e ç'ajri e asi, poshtë pa ushqim, pa asi. Aty-këtu dikush që iu sjellke diçka sa me e mbajtë, që thojnë, shpirtin mbas... mjerim ka qenë, ka qenë shumë tmerrshëm. Po krejt luftunë për diçka që... nejtë e arritën, i mashtrunë. Atëherë kërkoshin ndërrimin e Rrahman Morinës, Husamedin Azemit e... po si çdo send këtu te na, politika që i merr përsipër.

Anita Susuri: A ju kujtohet cilën ditë të grevës keni shku ju?

Dilaver Pepa: Na kem pasë shku dikah ditës t'katërt, t'pestë faktikisht, a din, atëherë fillunë në krejt Kosovën u bonë përkrahjet e minatorëve. Çdo fabrikë. U mbyllën punëtorët nëpër fabrika. Filloi njëfarë greve urie, a din, m'kujtohet që përgatitshin nëpër shpija me ju çu diçka me hangër nëpër fabrika. A din, e murr ni masivitet krejt Kosova. E aty ka qenë një ven... menjëherë mjerim. I kam nja dy-tri fotografi dikah t'rujtme. E veç me i pa ka qenë mjerim e le ma me i përjetu si ata sa ditë, s'pe di tash kom harru, sa ditë kanë ndejtë kanë qëndru.

Anita Susuri: Tetë.

Dilaver Pepa: Tetë ditë kanë qëndru.

Anita Susuri: Po.

Dilaver Pepa: Njerëzit u afroshin... ka qenë solidariteti qaq i madh që m'kujtohet kur kem dalë prej atyhit kanë ardhë njerëzit me ushqime, po diçka derdhshin... s'i lejojshin me e shti ushqimin, se faktikisht ata kishin shpallë grevë urie, kishin vendosë faktikisht me vdekë deri n'realizimin e kërkesave t'tyne. Po, sa u bo, e kem pa tana pak ma vonë (qesh).

Anita Susuri: A ju kujtohet çka ke... çka keni bisedu me ata edhe qysh ka qenë gjendja e tyne shpirtërore ose fizike?

Dilaver Pepa: Bisedat kanë qenë... kanë qenë natyrale, ato çka o bisedu në atë kohë... tonë kohën jom rovat [përpjekur] për shëndetin e tyne. "Si jeni? A po mundeni? Si po qëndroni?" Cigare shpërndamë sa kishim marrë me veti. Cigaren s'mujshin pa e dhezë. Po n'atë vend edhe cigarja m'u dokke asi... tmerr thojsha, ktu të mshelun, tym. Aty kish besa t'moshumë minatorë që mezi rrijshin. Po vullneti i madh, lufta për një Kosovë pak ma t'mirë, për një situatë për t'gjithë Kosovën, a din, iu... iu përmbajshin, se përndryshe shumë vështirë ka qenë.

Bisedat kanë rrjedhë... ata na pytshin, "Si o jashtë, çka po veprohet, tek po veprohet... nga ana politike?" Po atëherë edhe i mashtrojshin, "Jo po bohet, jo po jepin dorëheqje, jo s'po jepin". Kështu që, mu m'kujtohet, se unë kom qenë edhe ditën kur kanë dalë minatorët... edhe aty i mashtrunë, "Jo

jepën dorëheqje”. M’kujtohet fotografimi, me fasha... iu qitën fashat nëpër sy se prej tetë ditëve, dhjetë ditëve, sa kanë qëndru aty n’atë errësinë me dalë menjëherë jashtë, problem. I mashtrunë, faktikisht, i mashtrunë, si politika.

Anita Susuri: Fillimisht ata nuk e kanë ditë që, domethënë që i kanë mashtru. A ju kujtohet ndoshta reagimi i tyne kur e kanë kuptu që [nuk] paskan dhanë dorëheqje?

Dilaver Pepa: Reagimi ka qenë shumë i ashpër, po atëherë veç s’kishin çka me ba se u shpërnda masa. Shkunë nëpër shpija, shumicën i qitën prej punë, një pjesë t’madhe e burgosën. Këta si udhëheqësa që... kinse që kanë qenë. Burgosën [Azem Vllasin](#) atëherë, që deri dje ka qenë edhe ai në qat’ pushtet, po u ndrrunë që thojmë ne “kapuçat”, e hekën. Vështirë e kanë pasë, vështirë... m’kujtohet edhe kur kanë ardhë në Prishtinë n’kambë, minatorët. T’parët kanë fillu prej Mitrovice. Prej... prej Mitrovice erdhën n’kamë. Kanë qenë do tubime masive atëherë, prej krejt Kosovës u lëshu popullata n’kamë, me bicikleta, me çkamos asi... për me ardhë n’demonstrata, atëherë kanë qenë qaq masive, në ‘89-tën.

Anita Susuri: Edhe kto i keni fotografu a? Marshet?

Dilaver Pepa: Po edhe ato i kom fotografu. Marshet e... kom punu bajegi n’pritje të shokëve besa. I pritsha ata prej Pejës që vishin se atëherë u dukte me ndejtë dikah, me ju bo ni vend ku kanë me fjetë, ku kanë asi... kështu që jom marrë edhe me fotografim edhe me organizim, po mendoj, të shokëve të mi, qata që kanë ardhë. Vështirë ka qenë, mjaft ka qenë, po, unë thom shpesh një kohë e lezetshme o konë, a din, përjetimet mbesin tash veç n’kujtime, po shyqyr që na erdh edhe kjo, Kosova u shliu e...

Anita Susuri: Po. Çfarë ngjarje të tjera keni regjistru kështu me fotografi? Kanë qenë domethënë këto grevat, marshet, po pastaj n’vitin ‘89-të ka pasë edhe... edhe n’vitin ‘90-të, ka pasë edhe demonstrata tjera, të studentëve e... a i keni... a i keni fotografu edhe kto?

Dilaver Pepa: Fatkeqësisht, jo shumë, se te na u ndroreshin drejtorat fa... çdo gjashtë muj, a vishin një serb e një... ça po di unë. Politika atëherë vendoske gjithçka, kështu që nuk, nuk lejoi neve me dalë bar me aparaturë. Po nëse e kisha unë aparatën tem që e kisha, me ni shok, kështu për veti se jo diçka nuk na kanë leju kto, demonstratat e kto. Sa kem mujtë, kem vepru. M’kujtohet kur ka pasë ardhë ky i ndjeri kongresmeni Dole¹⁵. E dulëm me ni shok, unë e kisha edhe aparatën edhe fillova me fotografu para Grandit, ish masë e madhe, turmë e madhe tu e pritë. Po mbasi që shkoi kongresmeni prej atyhit, prej... hini në hotelin Grand edhe filloi masa me u shpërnda. Na atëherë e kishim zyrën afër, tash ku është Galeria edhe u kthymë. Ndërkohë mu po m’kërkon policia. Dikush kish lajmëru që kem gjujtë me gurë e kem thy kerre e... se u bo njëfarë rrëmuje, policia filloi me i ndjek kta demonstratat [demonstruesit] që ishin dalë me e pritë Bob Dole. Edhe erdh policia mu po m’kërkon, unë s’isha aty në Muze. Kur erdha tha, “Po t’kërkon policia”. “Për çka?” Tha, “Ki thy kerre”. “Çfarë kerre kom thy?”

Anita Susuri: (qesh).

¹⁵ Bob Dole (1923-2021) ish-senator amerikan i cili luajti rol të rëndësishëm në krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës.

Dilaver Pepa: E nime s’kisha thy (qesh). Po m’kanë mbajtë njo tetë orë n’polici. Atëherë ka qenë bajegi vështirë. Ka qenë një situatë ku i merrshin shqiptarët i rrehshin a i vrajshin a edhe i gjujshin n’rrugë. Më murrën mu edhe tash po pres po kqyri kah po m’çojnë me veturë. Kur e pava që m’çunë ka Radio Prishtina, atëherë te 92-shi, thashë “Jo, s’po m’çojkan dikah”. M’kanë mbajtë nja shtatë-tetë orë n’bisedë... biseda tylifare, gjithçka. “Jo ke thy, jo s’ke thy, jo çka ke bo, jo kush je, jo tek je”. Derisa ka ardhë... drejtoreshë e kom pasë atëherë... ajo ka qenë serbe besa. Erdh, tha, “Jo, ky është punëtor i zelltë, a din, s’ka bo asgja”. Mas njo shtatë-tetë orëve m’lshunë.

E gruaja shpesh e përmend ngjarjen kur iu kanë tregu që më ka marrë policia. Ka hi në arkivë teme të fotografisë ku i kem pasë. Fotografitë qeto, të minatorëve e ça po di unë, sende... m’i gjujtë mos po vijnë, tash me bo farë bastisje. Edhe u frigojke. Kjo ka qenë një ngjarje që m’ka mbetë atëherë prej Bob Dole.

E përcillshim ngjarje, faktikisht, politika na imponojke çka me përcjellë. Tregova pak ma herët, qato 25 Maji, Dita e Titos, se atëherë u festojke edhe mbasi që Tito kish vdekë, se ai ka vdekë në të ‘80-ën. Po u mbajke deri... hapja e farë fabrike, manifestime t’ndryshme, atëherë çdo jubile, një manifestim e mbajshin političarët. E kto faktikisht i kem përcjellë... edhe zhvillimin ekonomik. Çdo fabrikë që o hapë apo që ekzistojke, i përcillshim t’arriturat e tyre, kjo.

Anita Susuri: Që thatë ju kanë marrë n’pyetje, a ka qenë ktu në Burgun e Prishtinës?

Dilaver Pepa: Në stacion policor në 92-sh...

Anita Susuri: Aha.

Dilaver Pepa: Aty m’kanë mbajtë n’zyre nja shtatë-tetë orë. U ndrojjshin me pyetje t’ndryshme. Po, s’kisha bo, a din, mos t’bohna unë patriot tash asi, “Jo kom thy, jo...” kurgjo. Kishim shku, kishim ndejtë, kom pasë fotografu diçka asi. Por edhe ato s’di ku i kom, m’kanë hupë, se shumicën e sendeve i kem pas çu në Pejë. Në Pejë gjatë luftës na e kanë kallë shpinë e kanë hupë.

Anita Susuri: Deri n’cilin vit keni punu në Muze?

Dilaver Pepa: Në Muze kem fillu me ‘81, me 1 prill të ‘81, kom punu faktikisht deri në ‘92-tën. Në ‘92-tën vendosa, me vllaun n’bisedë, vendosa me e hapë dyqanin në Mitrovicë. Atëherë Mitrovica e kish një fotograf serb, nja dy-tre shqiptarë që ishin pak ma t’dobët me veprimtarinë e tyne. Edhe shkumë me pajisje moderne, me maqina t’reja për fotografitë kolor. E hapa në ‘92-shin dyqanin, udhëtojsha për çdo ditë Prishtinë-Mitrovicë. N’mëngjes shkojsha deri n’tre, n’katër në dyqan. Mas tre-katërve e kom pasë një punëtor. Ai vazhdojke deri n’gjashtë, shtatë.

Nja tri vjet kom punu. Mbas tri vjetve e hapa dyqanin në Pejë... në Prishtinë. Atë dyqan në Mitrovicë iu lamë, faktikisht, iu shitëm pajisjet atyne që ishin pronarë të dyqanit. E, e hapa dyqanin ku jem sot, në

'95-tën. Edhe prej '95-tës, veprimtar... veprimtarinë e zhvilloj qaty qe ku jom. Atëherë me qira. Mas luftës filloi një punë pak ma... ma e madhe. Atëherë s'kish fotografi, ju vyjke... jo për dokumenta të ndryshme edhe... e bleva dyqanin. Ka qenë dyqani i një shqiptarit. E bleva dyqanin, kështu që sot është dyqani im. Punojnë fmitë. Unë ju ndihmoj kapak sa muj, sa po munden me m'duru (qesh).

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Në ndërkohë m'i përmendët disa ngjarje tjera edhe po du me u kthy te ato. Tregutë për vitin '89-të kur u bo suprimimi i autonomisë së Kosovës edhe kur u ndryshu Kushtetuta. Thatë që e keni përcjellë ngjarjen.

Dilaver Pepa: Në '89-tën zhvillime shumë t'mdhaja në Kosovë. Një ndër ato u bo edhe ndryshimi i... filloi përgatitja për ndryshimin e Kushtetutës të '74-ës. E na si Muze i përcillshim faktikisht, mos t'thom çdo mbledhje të Kuvendit, po shumicën e mbledhjeve të Kuvendit të Kosovës i përcillshim. Na vyjshin për dokumentacion të Muzeut. Kur fillunë përgatitjet për këtë mbledhje, atëherë veç krejt Kosova vlojke, faktikisht. Ishin çu popullata kundër... kundër ndryshimit të Kushtetutës, se me ndryshimin u suprimojke krejt Kosova, faktikisht, bijke ndër sundimin e Serbisë. Një pjesë e madhe, po foli prej shtypit, prej përcjelljes, prej bisedave, ishin që nuk do të lejohet ndryshimi i Kushtetutës. Po presioni i Serbisë, i policisë, ka qenë i hatashëm. A din, n'atë kohë, n'ajër u ndijke, ajo atmosferë, a din, që ish tepër acaruese faktikisht. Edhe filloi mbledhja... unë me këtë Mehmetin na çunë me e përcjellë mbledhjen.

Filloi mbledhja, fillunë diskutimet. Në fillim u dokke, prej përshtypjeve tona u dokke që, faktikisht, nuk po dojkan me e leju ndryshimin e Kushtetutës. Fol njeni, mirë, fol tjetri, mirë. M'kujtohet ka qenë Melihate Tërmmkollli, Rizah Lluka i Pejës. Do tjerë të Pejës, a din, i di, me emra, Menduh Shoshi, Gusija, e shumë e shumë tjerë. A din, s'po m'kujtohen tash, ka pasë jo akademikë, ka pasë n'rend të parë unxhun, Stavileci, a din mos t'i përmendi tash. Edhe diskutime njo pas njonës, njo pas njonës, tu i mendu, në bashkë... në bisedë me këtë shokun, a din, u gzojshim, thojshim, "Po dojshim me fitu, s'po dojkan me e lonë ndryshimin e Kushtetutës". Me ndryshimin, bijke faktikisht Kosova krejt nën sundimin e Serbisë edhe s'kish mo atë autonominë që e ka pasë deri atëherë.

Kur të nesrit, filloi ndërhyrja e policisë te deputetët e çka po di unë, e filloi veç me u ndryshu atmosfera. E unë fotografojsa tonë kohën. Edhe tash, përveç që fotografojsa për Muze, ish interesimi si person... m'interesojke çka po ndodhë, tek po ndodhë, kush çka po thotë. Edhe fillunë me t'madhe me u frigu deputetët. Një pjesë e madhe veç u pa që e kthynë kahjen. Fillunë, "Jo, s'kem me hupë na kurgjo prej ndryshimeve të Kushtetutës, jo kështu, jo ashtu". Ishin qeta, Melihate Tërmmkollli, Rizah Lluka, një pjesë, kanë qenë nja tetë a dymbëdhjetë që kanë pasë votu kundër. Ajo si ngjarje m'ka mbetë, që thojnë, e pashlyeshme. Por, fatkeqësisht e hupëm, e votunë shumica, e hupëm edhe qat' Kushtetutë që e kem pasë të '74-tës. Edhe fillunë trazirat me t'madhe, mbarë Kosovës, mbas ndryshimit të Kushtetutës.

Anita Susuri: Në '92 thatë që jeni largu prej punës. A e keni lanë ju punën, apo...

Dilaver Pepa: Ah po. Në '92-tën faktikisht unë e morra... e kom pasë një drejtoreshë e ajo ma lejoi një pushim pa pagesë. E dije që unë... i thashë, "Po du me e hapë një dyqan". Fëmijët, veç i kisha atëherë dy fëmijë. Shoqen... ajo punojke shoqja veçse edhe atëherë... edhe vendosa me e hapë një dyqan edhe i thashë qeshtu, qeshtu, thashë, "Jom n'gjendje qe kur keni nevojë", se atëherë mbetën pa fotograf Muzeu, "Kur keni nevojë, m'thirrni, vi, i kryj punët" edhe m'lejoj. Pushim pa pagesë mora, një vjet, faktikisht. E çela dyqanin. Tana e lëshova se e pava që ma nuk ka gjo prej asaj pune që do të kthehna n'punë.

Tri vjet në Mitrovicë, mbas tri vjetve, e mora e çela, e hapa dyqanin në Prishtinë. Edhe prej asaj dite, pak ma herët e ceka, qetu. Ngjarje tjetër kanë qenë delegatët kur iu mbyllën dyert e Kuvendit. Kur e shpallën Kushtetutën, kur e shpallën para dyerve. Po, atëherë u duhke msheftë pak se nuk lejojshin Muzeu... kishim na aty nja pesë-gjashtë serbë që punojshin. Faktikisht, ata kurgjo s'punojshin veç na përcillshin neve, shqiptarëve, çka po bojme tek po bojme. Na ishim faktikisht një tabor tjetër, ata një tabor tjetër. E kështu që, nuk na lejshin me shku me i përcjellë me fotografi, me këto. Po, shkojshim, në suaza t'asaj çka mujshim vetë me bo, me një aparat timin. E...

Anita Susuri: E po m'intereson gjatë kësaj kohe, domethënë, në '90, kur keni punu në Muze, a kanë ndryshu ekspozitat, ekspozitat, sasia e ekspozitave. A ka ndryshu diçka?

Dilaver Pepa: Po derisa kom qenë unë atëherë ka qenë qajo e njejta. Qato fotografi që i kem punu, prej qasej, prej qatij dokumentacioni që i kem mbledhë, prej hulumtimeve t'ndryshme, se ka ekzistuar mundësia... jo që ka ekzistuar mundësia, po u duhtë, për shembull, nëse farë ekspozite tematike, enkas me shku hulumtimin me e bo edhe për diçka që t'ka mungu n'atë ekspozitë. Derisa unë kom qenë, pak ka ndryshu, a din, në ekspozimin e ekspozitave. Faktikisht 80 përqind kanë qenë ekspozita fotografike.

A din, aty këtu, ekspozite i kem pasë do arka t'marume prej xhamit, armë të ndryshme, nëse osht' tematika e luftës, apo diçka tjetër, s'po di, libra, fletore, a din... këto ekspozite ma tepër që janë përdorë prej atyne personaliteteve që o bo ekspozita... E me kohë, unë mbasi që e kom lëshu Muzeun si Muze, nuk ka ekzistuar Muzeu i Revolucionit, se një pjesë i kanë qitë prej pune n'vitet e '90-a, si krejt shqiptarët që i kanë qitë. E një pjesë u bart administrata, aty këtu ndonjë historian, shkunë në Muze të Kosovës... deri mbas lufte. Mbas lufte apert startunë si Muzeu i Kosovës, veç Muzeu i Revolucionit faktikisht u shemb, u zhduk.

Anita Susuri: Po m'intereson këto fotografi që i keni bo, për shembull, prej grevës. A janë ekspozu ato, për shembull në Muze, a çka u bo me ato fotografi?

Dilaver Pepa: Jo, fotografitë e minatorëve nuk janë ekspozu kurrkah hiç, se s'kanë leju atëherë me i qitë. Po ekzistojnë... janë në dokumentacion. Nëse, falë Zotit ishalla i kanë ruajtë, ekzistojnë fotografi në dokumentacion të Muzeut të Kosovës. Tash sa kanë qenë për ruajtje, sa asi, nuk... nuk di.

Anita Susuri: Nëse mundeni me na tregu vitet e fundit të '90-ave. Domethënë, në '98-ën, veç fillon me, me shku gjendja n'luftë, bile n'disa vende nëpër Kosovë, veç zhvillohet lufta. Qysh ka qenë këtu në Prishtinë gjendja edhe qysh ka vazhdu pastaj deri n'luftë... deri në bombardime?

Dilaver Pepa: Unë e kom pasë banesën afër dyqanit, në Dardani, te Santea. Situata ka qenë (psherëtinë), s'po di, a din, çfarë përshkrimi me jep, po mjaft e vështirë. Cigaraxhitë shitshin cigare rrugës këndejna. E shihshin ni polic, vrapin me t'madh, se ai iu grabitke jo me t'holla, jo me cigare, çka kish. Po jeta u zhvillu nëpër kafiteri, studentat, a din, atëherë ka pasë shumë studenta, dilshin. Po gjithmonë ka qenë me një frigë, me një, "Çka po ndodhë?" Para demonstrat... para, faktikisht, para luftës, m'kujtohet si sot kur e kanë vra këtë Adriana Matoshi¹⁶ a? Artistën.

E unë e kom banesën mbi... atëherë ka qenë kafiqi Le... "Magjiki". Unë mbi "Magjik" e kom pasë banesën. Ndejtëm n'dyqan deri kah ora pesë-gjashtë [pasdite] se i avitshim, i mbyllshim dyqanet ma herët, situata s'ish e lakmueshme. Mrriva n'asi... krejt kafiqat faktikisht ishin mbyllun, kur kto, qet' kafiq "Magjikun" po e shoh hapun. Thashë, "Kta s'jonë bash" se... hina n'banesë, nuk ka shku një orë, kur jonë ndi rafallat *brrrr* {onomatope}. Thashë, "Qetu dikon e mbytën". Tash prej dritarës po kqyri, erdh policia e erdhën gazetarët me t'madhe asi. Veç murrën vesh që, asi, o gjujtë. Kanë qenë Enver Petrovci, qekjo Matoshi, artistja që vdiq. Kanë qenë edhe nja tre-katër... ai e mbajke "Hanin e Dy Robertëve", ai ka qenë. Kështu që, murrën vesh që vdiq një asi artiste, një vajzë. Ata jonë dalë me e festu një provim a, s'po di çka.

Anita Susuri: M'tregutë për rastin e Adriana Abdullahut që është vra në atë kohë. Çfarë përjetimi tjetër keni pasë n'atë kohë? Për shembull, kur kanë fillu bombardimet. Ajo ka qenë koha kur veç u...

Dilaver Pepa: Qat' kohë, po faktikisht...

Anita Susuri: ...u bo kulmi i përkeqësimit të situatës.

Dilaver Pepa: Qat' kohë, dy-tri ditë përpara se me fillu bombardimet, bombardimet me 24 [mars] kanë fillu. Situata në Prishtinë, n'përgjithësi në krejt Kosovën ka qenë shumë tensione... e tensionume. Dyqanet i mshelshim herët. Shkojshim faktikisht para territ. Nuk punojke asgja, u mbyllke faktikisht Prishtina. E, m'kujtohet qat' ditë sa shkova n'banesë, ish ora dikah pesë, s'po di tash tamon, mos t'asi... Hina n'banesë, mbas nja një ore veç filloi terri me ra edhe u ndinë rafallet, *brrrr* {onomatope}. P'i thom shoqes, a din, ajo shoqja u tmerru. Thashë, thashë "Dikon e mbytën qetu qe". Se ishim n'katin e dytë, tamon mbi kafiq, kafiqi "Magjik" ka qenë atëherë. Edhe dulëm në dritare m'i pa... jo me i hapë dritaret se s'guxojshim as dritaret me i hapë faktikisht, po u duhke anash e me... me i ndalë dritat e... u bo diqysh huti e madhe. Erdh policia, policia serbe. Erdhën gazetarët kinse për informim.

¹⁶ Folësi e ngatërron aktorën Adriana Matoshi me Adriana Abdullahu e cila është vrarë pak ditë para intervenimit të NATO-s në ish-Jugosllavi.

M'kujtohet një prokurore ka qenë shumë e keqe, serbe, Desanka, s'di qysh e ka pasë mbiemrin, po atëherë ka qenë faktikisht, ajo udhëheqke me krejt këto ngjarjet çka po ndodhin, ajo ka qenë iniciatore e tona t'kqijave. Edhe veç kur murëm vesh a, *Deutsche Welle*¹⁷ a s'di kush i jepi lajmet, sa m'kujtohet kjo Valentina Saraçini¹⁸, që vdiq Adriana Abdullahu, kjo artistja e Gjilanit [Ferizajit]. Aty kanë qenë prezent Enver Petrovci, ka qenë pronari, s'po m'kujtohet emri [Fadil Dragaj], i "Hanit të Dy Robertëve". Kanë qenë edhe nja dy-tre, nja pesë-gjashtë vetë kanë qenë krejt aty kur ka ndodhë kjo ngjarje. Edhe mbas dy-tri ditëve, faktikisht edhe filloi bombardimi... bombardimi, që e pritën tërë shqiptarët, e pritën me gëzim (buzëqesh).

Unë e kisha edhe vjehrrën prej Pejës m'kish ardhë, kish mbetë këtu, a din, se qarkullimi i autobusave nuk... nuk lëvizshin faktikisht... mbeti te unë. Gëzim i madh *ooo* {onomatopea}, po gëzimin e madh me njëfarë asi qetësie, njëfarë asi... çka po ndodhë tash? Veç e pamë bombardimin kur e bombardunë... këtu te posta, flaka. Atëherë mujshim me e vrejtë. Këtu ka qenë një depo, te ish-fabrika e pllantikës, një depo e benzinit. Atëherë, *kasarna* [Srb.: kazerma] e ushtar... e ushtrisë gjujtën, kallën. Veç filloi, që thojmë na, "E paskan përnime, jo për mahi". Po filloi tana frika, menihere pas saj, se t'nesrit u duhke tash me dalë me ble bukë a diçka, i kishim fmitë. U mshelën me t'madhe, a din, prej frikës. Delshin gratë, motrat, me ble bukë se neve s'na lejshin se filloi qarkullimi i serbëve, qarkullimi i paramilitarëve, malltretimet, besa burgosjet e vrasjet e...

Dyqanin e kisha mbyllë. Ajo, shoqja po m'thotë, "A ki diçka n'dyqan?" Thashë, "Jo, s'kom". Erdhëm t'nesrit, mas bombardimeve, me 24 [mars, 1999], faktikisht me 25, erdha diçka me marrë, s'di këtu n'dyqan çka. Po e kishim mbyllë me perde, që mos m'u pa brenda, e marrëm qato. E kisha një telefon, një rast, a din, frika pak ka qenë e madhe, ta përkujtoj. E kisha një telefon ajror, që mujsha me bisedu shpi me banesë. Edhe e kisha marrë telefonin prej dyqani, thashë mos ta lo këtu, ta marr n'banesë. Kur kem mrrri në gjysë të rrugës qetu te semaforat, djali Asdreni, a s'di kush po thirrë n'telefon tash me vetë a jom, ku jom. Ai po m'bon telefoni n'çantë që e kish shoqja. E m'kapi njëfarë panike asi, p'i thom, "Ku ju desht asi me thirrë?" Po, zatën pshtumë. Kush s'e ndijti. Hinëm n'banesë.

N'banesë kem qëndru njëmbëdhjetë ditë, unë si patriot, po foli kështu... p'e boj vetin patriot (qesh) a din thashë, "S'du me e lshu Kosovën, po rrijmë këtu". Unë, shoqja, tre fmijë, vjehrrën e kisha, motrën e morra. Ajo vetëm n'banesë edhe ato e morra. E i kishim edhe kojshitë, ai... njëfarë Orhani doktori edhe gruaja e vet edhe dy fmijë erdhën te unë. Rrijshim qaty s'bashku, përgatitishim e... e lshunë banesën krejt. Banesa tetë kat... nëntë katëshe, faktikisht mbeti zbrazët, përveç serbëve.

Pas tri ditëve erdhën do... mos t'thom asi do t'ri serbë, që ishin huligana faktikisht, hajna. Edhe trokasin n'derë. Në t'vërtetë, mbas nëntë ditëve... edhe po ma lypin veturën. Kisha një veturë Renault 5-she, bajegi që m'dhimet edhe sot e atë ditë. Tha, "Me ma jep kerrin", serbisht. Thashë, "Jo, ti s'ki as patent as... qysh me ta jep?" E unë kerrin e kisha n'parking te Santea. "Jo se po dojmë me shku deri në Obiliq", e a din përrallat e atyne. Filloi shoqja e motra, frika ju hini, a din, qysh e tek e... Ai të nesrit

¹⁷ Transmetues ndërkombëtar publik gjerman.

¹⁸ Gazetare, shkrimtare e këngëtare nga Shkupi, e bazuar në Kosovë. Kontribuese e jashtme për *Deutsche Welle* dhe reportere lajmesh për RTK-në.

prapë. Tha, “Qy! Unë muj edhe me ta kallë kerrin”. Thashë, “Ti mundesh valla gjithçka”. M’kapi mu njëfarë asi inati. Thashë, “Ti mundesh edhe me e kallë, po unë s’ti jepi”. Insistimi i shoqes, e grusë e tha, “Jepja amon se...” a din, “po na ndodhë...” veç ndodhshin sende t’ndryshme. Ja jepa çelësat e kerrit.

Mbas dy ditëve na u duhtë, se u bo veç që s... e padurueshme me ndejtë... jo trokitjet e... fmijetë fillunë me t’madhe m’u frigu. Vendosëm me dalë. I murrëm valixhet, unë me qat’ kojshinë edhe në stacion të trenit. Atëherë trenat qarkullojshin Prishtinë-Bllace, deri atje. A din, janë përjetimet e çdo shqiptari që i ka përjetu e i ka pa, a din. Mos t’hi në detaje, po vështirë ka qenë, tmerr ka qenë. Por, në atë fatkeqësi, krejt prej Bllacës e patëm një fat të mirë. Mas dy ditëve shkumë në Gjermani.

U regjistruamë n’ato regjistrimet e UNHCR-it a kush i organizojke. Na çunë në Gjermani. Nja tre mujë kem ndejtë në Gjermani. Me aeroplanin e parë jem kthy. “Jo po rrijmë, jo s’po rrijmë”. E kisha vllaun në Belgjikë tha, “Pse s’po rrin?” Thashë, “Valla po du me u kthy në Kosovë”. Me aeroplanin e parë jom kthy në Kosovë. Jeta filloi prapë me vazhdu. E hapa dyqanin qysh e kisha... e kishin vjedhë dyqanin. Krejt maqinat m’i kishin vjedhë, t’thymë. Po u duhke me fillu prej diçkafit. Fillumë kadal-dale, kadal-dale. Filloi puna.

Anita Susuri: Deshta edhe pak me u kthy te Bllaca se t’pashë edhe që e keni fotografu atë...

Dilaver Pepa: Bllacën.

Anita Susuri: ...domethënë atë përjetim.

Dilaver Pepa: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë për juve, sa keni qëndru aty? Qysh keni kalu pastaj?

Dilaver Pepa: Në Bllace... gjatë luftës kur... tregova që kem shku me tren. Dulëm n’mëngjes. Guzhvë e madhe, mezi u... u vendosëm n’tren, e nxonëm një kabinë. Mbrrijtëm në Bllace, mbrrijtëm disi. Kur zhdrypëm prej trenit, ai një... a që e udhëheqke trenin, a kondukter a... po na thotë, “Kadale, ecni vetëm nëpër binarë se jonë rrugët e minume”. Tash po foli prej vendit ku u ndal treni deri me shku në... në Bllace aty ku ishin vendosun shqiptarët e mjerë n’ato shatora që me i pa tmerr.

Nejse, mbrrijtëm, shi, lloq. U vendosëm disi. Fillunë me na ndihmu do shokë, do asi t’njofshëm, me e mbaru një shator prej najllonit. Tash ishim bajegi... unë isha vetë i pesti në familje, motra, vjehrra, vetë i shtati. Ky kojshia vetë i katërti edhe një kojshi tjetër pat’ ardhë me ne, kështu që u bomë gati nja njëzet vetë. Edhe me u vendosë njëzet vetë me një shator prej najllonave t’marumë. Po u vendosën fmijetë ma s’pari, gratë... na burrat delshim u shetitshim. Edhe kishim me teshë [takuar] dikond, me pa a ka pshtu, a s’ka pshtu a qysh...

E osht' interesant me e përmend vajzën time. Ajo i kish mbledhë një torbë, unë tu mos ditë, një torbë me fotografi. Krejt torbën e ka mbushë me fotografi. Thojnë, faktikisht, kur vdesin kujtimet, vdes historia, s'ka mo. Ndër fotografitë që i kish marrë, aty kanë ekzistuar edhe nja dy filma, që kanë mbetë. Në Bllace e tasha një shok, Namik Rexhën, tha, "E kom unë një aparat". Po ma bon, "Dilo", tha, "e kom një aparat". Thashë, "që unë i kom filmat. A po ma jep aparatin?" Ma jepi aparatin. Fotoqrafova Bllacën. Në Bllace kem qëndruar nja katër ditë... tri ditë. Faktikisht kem dalë me 3 prill, me 7 [prill] kem dalë prej Bllacës në Stankovec. Fotoqrafova, osht' mjerim me e pa, i kom fotografitë. Fotoqrafova qata dy filma.

Fati deshti shkova në Gjermani. Kur shkova në Gjermani, i zhvillova filmat te një fotograf. P'i shoh, a di, fotografitë qato mjerimin që e kem pa, po tash po e përjeton ndryshe, tash prej një perspektive... se tash ishim në Gjermani faktikisht, a din, s'e kishim at' dronë [druajtjen]. Edhe i panë fotografitë, fillunë gazetaret gjermanë me ardhë, intervista t'ndryshme e asi. Mes tjerash, një gazetarë edhe p'i sheh fotografitë, tha, "A bon m'i përdorë?" "Ouf" {onomatope}, thashë, "qysh jo!" A din, na mezi pritshim tash me u publiku me e pa çka po hjekin shqiptarët. Edhe i kom... edhe gazetaret i kom t'rujtme. I publikunë fotografitë e Bllacës, nja dy fotografi, qato ma t... faktikisht të tmerrshme me i pa.

E mbas nja katër-pesë ditëve po m'vjen një bashkëpunëtor i qasaj gazetares, po ma bjen një zarf. M'i pruni njëqind marka. Thashë, "Çka?" {ngre supet}. A tha, "Na e kemi asi... si obligim gazeta e ka çka publikon me u pagu". Thashë, "Unë s'e kom bo për pagesë, e kom bo ma tepër... le t'afirmohen një send asi". E m'kujtohet, a di, çfarë gjesti, njëqind marka m'i jepën për qat' publikimin e fotografive. I kom gazetaret, s'di qysh e pat' emrin, se gjermanishten s'e di. E ndejtëm tre muaj në Bllacë... në Gjermani. Ka qenë një fshat Puschendorf¹⁹, fshat i lezetshëm.

Anita Susuri: Kur jeni kthyer këtu, qysh e keni gjetë dyqanin, banesën?

Dilaver Pepa: Dyqanin e kom gjetë krejt t'vjedhun. I kom pasë maqinat... atëherë kanë kushtu bajegi qato maqina që i kom pasë njëherë në Mitrovicë. Tana i morra unë ma t'rejat, ato i lashë në Mitrovicë. I vjedhën. Maqina e zhvillimit të filmit, veç ajo ka kushtu dikah atëherë 50-60 mijë marka. Maqinën e filmit s'kanë... s'kanë nxirrë çka po di unë, po e kanë shkatërru, e kanë... Dyqani i thymë, t'gjyjtme... erdha. E kom pasë një punëtor atëherë, ai ish ardhë një ditë a dy ditë para meje. Tha, "A t'ja nisi me e pastru?" Thashë, "Nisja me e pastru", thashë, "unë vi shpejt". Atëherë e kisha dyqanin me qira. Pastrumë, fillumë kadal-dale, kadal-dale. Filloi puna m'u zhvilloi. Jeta... jeta filloi veç ma ndryshe. Pak e ndijshim atë lezetin, që thojnë, e lirisë, a din s'e kishim ma atë frikën. Kjo...

Anita Susuri: Tash punën e kanë trashëgu edhe djemtë e jujë, a po?

Dilaver Pepa: Po (buzëqesh).

Anita Susuri: Vazhdoni me këtë profesion...

¹⁹ Komunë në qarkun e Fürth në Bavari në Gjermani.

Dilaver Pepa: Neve na ka mbetë kjo një trashëgimi prej... na prej babës, këta prej neve, faktikisht edhe gjenarata e tretë a e katërt që po merren. Unë jom penzionist, po hala dal n'dyqan. Ju përgatis mëngjesin e mirë, ju pastroj dyqanin ju... t'gatshme. Kështu që, i kom dy djemtë, kom edhe vajzën. Ajo është... e ka kry Fakultetin Ekonomik në Angli. Punon në Ministri të Integritimit. Këta dy djemtë edhe këta kanë studiu, po edhe këta i kanë lonë pak studimet, me pushu. Njani ekonominë, tjetri juridikun. Po kanë fillu me zanat, e dojnë zanatin, e dijnë zanatin, i kanë kushtet. Tash ishalla me t'mira i prijnë.

Anita Susuri: Zotëri Dilaver, nëse doni edhe diçka për fund me shtu... ose që keni harru me e përmend ose që...

Dilaver Pepa: A di, jeta është shumë, thojmë shumë zgjatë, po qaq e shkurtë është, kur t'kalon ajo t'doket një sekucencë një sekond, dy... dy minuta. Sigurisht që kom harru shumë sende, po osht' koha qekaq sa na premton. Nashta, ndonjëherë tjetër.

Anita Susuri: Faleminderit shumë për intervistën edhe për kohën.

Dilaver Pepa: Faleminderit edhe prej juve.